



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

OSHP. nr. 821/2024
Data e vendimit: 19.09.2024

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020 pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit ekonomik (OE) "BERVENIKU CORPORATION SH.P.K." lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me dru dhe pelet" me numër të prokurimit 651-24-7508-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL - GJILAN., zv. Kryesuesi i Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Agim Sheqiri me datën 19/09/2024, mori këtë:

VENDIM

I.Hedhet si e palejuar, ankesa e "BERVENIKU CORPORATION SH.P.K." me nr. të protokollit 2024/0821, e datës 09.09.2024, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me dru dhe pelet" me numër të prokurimit 651-24-7508-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) - KUVENDI KOMUNAL - GJILAN.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues – KUVENDI KOMUNAL - GJILAN., që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me dru dhe pelet" me numër të prokurimit 651-24-7508-1-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik e-prokurimi me datë 30.08.2024, tek rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE “BERVENIKU CORPORATION SH.P.K.” për aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me dru dhe pelet” me numër të prokurimit 651-24-7508-1-1-1, inicuar nga KUVENDI KOMUNAL - GJILAN., në cilësinë e autoritetit kontraktues.

Zyra e pranimit të ankesave pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka kryer pagesën siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së dhe nenin 69 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Nisur nga fakti se ankuesi ankesën e lartcekur, nuk i ka bashkangjitur konfirmimin e bankës për tarifën, edhe pse zyra për pranimin e ankesave me datën 11.09.2024 përmes email-it e ka njoftuar OE ankues se ankesës se pas ekzaminimit të shkresave që i keni bashkangjitur në platformë OSHP, ka konstatuar se nuk keni kryer pagesën siç parashihet në paragrafin 2 të nenit 69 të rregullores 001/2022 të prokurimit publik citojmë nenin 69.2 “Në përputhje me nenin 118 të LPP-së, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarife të ankesave në OSHP. a. Kurdo që ankesa ndërlidhet me vendimin për shpërbllim të një kontrate, shuma e tarifës se ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5, 000 Euro”. andaj luteni që afatin e mbetur të na e përcjellin dëshminë lidhur me pagesën **në të kundërtën Ankesa do të refuzohet.**

Ndërsa sqarojmë se OE ankues “BERVENIKU CORPORATION SH.P.K.” lidhur me emailin e dërguar nuk ka kthyer përgjigje lidhur me emailin e dërguar nga OSHP.

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE “BERVENIKU CORPORATION” SH.P.K.” e datës 09.09.2024 (protokoll 0821/2024), për aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me dru dhe pelet” me numër të prokurimit 651-24-7508-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) KUVENDI KOMUNAL - GJILAN., konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së.

Andaj procedura e shqyrtimit të kësaj ankese përfundon në këtë fazë duke e hedhur të njëjtën si palejuar - jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet dispozitat ligjore të lartcekura.

I lejohet, autoritetit kontraktues – KUVENDI KOMUNAL - GJILAN., që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru dhe pelet” me numër të prokurimit 651-24-7508-1-1-1,

përkítazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit. Megjithatë OSHP i vë në dijeni AK, se në çdo aktivitet duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60 të LPP-së.

Zv. Kryesuesi i OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Gjilanit

1x1 OE. “BERVENIKU CORPORATION” SH.P.K.”

1x1 Arhivës së OSHP-së;

Agim Sheqiri

Ud. Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së

